



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Limited Project" Sh.P.K. të datës 17.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Limited Project" Sh.P.K. e datës 17.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Limited Project" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Limited Project" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 17.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritator (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimi i parë:** “Deklarata e Garancionit e datës 07 shtator 2023 përmbanë të gjitha elementet e rëndësishme të një garancioni, si aktivitetin e prokurimit, emërtimin dhe numrin e aktivitetit, autoritetin kontraktues dhe kohëzgjatjen e garancionit, dhe poashtu nuk përmbanë parakushte lidhur me rastet se kur garancioni nuk do të jetë i vlefshëm. Për më tepër, Deklarata e Garancionit e dorëzuar nga OE Ankues Limit Project Sh.P.K., përmbanë një referencë të qartë për momentin se kur do të filloj të rrjedhë Garancioni, e që nënkupton se i njëjti E KA garancionin e lëshuar nga vet prodhuesi. Për më tepër, është tërësisht e pakuptueshme pse është kërkuar garancion nga prodhuesi kur procedura e zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues ka të bëjë lidhur me Punë dhe jo me Mallëra. Neni 658 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parasheh përgjegjësinë e ndërtuesit (punëkryerësit) për të metat e godinës dhe jo atë të prodhuesit të një materiali apo produkti të caktuar. Pra në bazë të kësaj dispozite – e cila edhe pse nuk është pjesë e legjislacionit të Prokurimit Publik – por që duhet të mirret parasysh nga ana e Autoritetit Kontraktues, është dashur që të kërkohen informata shtesë lidhur me Deklaratën për Garancionin, meqë OE Ankues Limit Project Sh.P.K., ka vepruar konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, edhe pse i njëjti e ka pasur edhe garancionin e prodhuesit”.

**Pretendimi i dytë:** “Në dosjen e tenderit ne kemi paraqitur listën e stafit nga kompanitë pjesëmarrëse, ku sipas nenit 72 keni mundur të kërkonit sqarim nëse janë të trajnuar pjesa tjetër e stafit, ku AK, si duket nuk e ka analizuar dosjen në tërësi, pasi që, nuk mungojnë certifikatat për 11 persona, por maksimum për 4. Për më tepër GOE LIMIT PROJECT SHPK dhe të tjerët në grup, janë kompani të përgjegjshme dhe tërë stafi është i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë dhe sipas Nenit 72 keni mundur të kërkonit sqarim”.

**Pretendimi i tretë:** “Autoriteti Kontraktues thekson se Plani Dinamik nuk hapet dhe për këtë kanë kërkuar interpretim nga KRPP, duke theksuar se meqë madhësia e RAR File është 1KB, nënkupton që RAR File është si zbrazët. Një pretendim dhe arsyetim i tillë për eliminimin e OE Ankues është i pabazuar, pasi që AK, do të mjaftonte që të kërkonte sqarim sipas Nenit 72”.

**Lidhur me pretendimet ankimore** duhet sqaruar se arsyet për eliminimin e parashtresit janë evidentuar nga komisioni vlerësues si në vijim:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :**

- Është kërkuar gradacioni minimum 1 vit nga prodhuesi për pozicionet sipas pikës 6, mirëpo OE e ka dorëzuar deklaratën e nënshkruar nga vet si operatorë, andaj i njëjti kusht nuk plotësohet.
- Pika C për punëtorët fizik ku është kërkuar certifikata për siguri dhe shëndet në punë mungojnë certifikatat për 11 punëtorë.
- Plani dinamik i kërkuar nuk hapet, për të cilin është kërkuar interpretim nga KRPP si me poshtë :  
(Ne sistem te prokurimit elektronik dhe oferten e GOE LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA – CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; ILEAA - GR SH.P.K te dorëzuar ne aktivitetin e prokurimit me Nr. 616-23-7338-5-1-1 evidentohet qe oferta e shkarkuar permbane folderin e kompresuar ne formatin RAR me Nr 15 te emertuar si Plani Dinamik.rar por me kapacitet prej 1KB qe nenkupton se eshte folder i zbrazet dhe nuk permbane asnje dokument per ekstraktim ( shiko PS te bashkangjitur ne kete e-mail). Ky folder me te njejtin emertim. format dhe kapacitet eshte ngarkuar nga OE ( perdoruesi "limitproject") me date 20.09.2023 dhe kohe 13:18min.

Fillimisht duhet theksuar që parashtruesi nuk i kundërshton arsyet për eliminimin e tij në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Kjo për arsye se nuk i mohon këto arsye për eliminimin mirëpo thjesht pretendon se autoriteti kontraktues është dashur që të kërkoj sqarime shtesë nga parashtruesi në mënyrë që ti jap mundësi të njëjtit për të përmisuar gabimet e lëshuara në ofertën e tij me rastin e tenderimit. Nga ky këndvështrim vlen të thuhet se mundësia për sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP nuk e detyron autoritetin kontraktues që të kërkoj sqarime shtesë sa herë që tenderuesit nuk e dorëzojnë ofertën e tyre në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Pra ideja e sqarime shtesë nuk është që tu jap mundësi të dytë tenderuesve për të ngarkuar dokumentet që nuk kanë dorëzuar asnjëherë por vetëm është mundësi (jo detyrim) që ka autoriteti kontraktues për të kërkuar sqarime shtesë atëherë kur ka dilema mbi dokumentet e caktuara të tenderuesve.

Sa i përket pretendimit të parë ankimor që i referohet arsyes së parë për eliminimin, nga oferta e parashtruesit është gjetur se i njëjti nuk ka dorëzuar deklaratën e garancionit nga prodhuesi por ka dorëzuar një deklaratë të nënshkruar prej vet parashtruesit. Rrjedhimisht nuk e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Parimisht këtë fakt nuk e konteston as vet parashtruesi por vetëm thotë se autoriteti kontraktues është dashur që të kërkoj sqarime shtesë. Në rastin konkret nuk është dorëzuar fare deklarata nga prodhuesi prandaj nuk mund të kërkohej sqarime shtesë mbi një dokument që nuk është dorëzuar asnjëherë pasi që kjo do të përbënte ndryshim material të ofertës që është në kundërshtim me nenin 72 lidhur me nenin 59 të LPP. Sa i përket pikës së pretendimit ankimor ku thuhet se kjo kërkesë e dosjes së tenderit është e paarsyeshme, vlen të shtohet se parashtruesi ka pasur mundësi që të kërkoj sqarime apo të parashtroj kërkesë për rishqyrtim lidhur me kërkesat e dosjes së tenderit deri në momentin e hapjes së ofertave. Mirëpo në këtë fazë nuk mund të kontestohen kërkesat e dosjes së tenderit pasi që ka përfunduar vlerësimi i ofertave. Sa i përket dispozitës së LMD të cituar nga parashtruesi, duhet cekur se kjo dispozitë nuk përbën normë materiale të zbatueshme në këtë aktivitet të prokurimit por edhe sikur të ishte ndryshe, kjo dispozitë në asnjë formë nuk e detyron autoritetin kontraktues të kërkoj sqarime shtesë për një dokument që nuk është dorëzuar asnjëherë (pa çka se nuk ka çfarë të sqarohet në këtë rast kur kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë e kuptueshme ndërsa dokumenti i tillë nuk është dorëzuar nga parashtruesi me rastin e ofertimit).

Sa i përket pretendimit të dytë dhe të tretë ankimor që i referohen arsyes së dytë dhe të tretë për eliminim, parashtruesi sërish nuk i kundërshton drejtëpërdrejtë arsyet e eliminimit por vetëm pretendon se autoriteti ka qenë i detyruar që të kërkoj sqarime shtesë. Në fakt te pretendimi i dytë vetëm e konteston numrin e punëtorëve ku thotë se nuk janë 11 punëtor por mund të jenë maksimumi deri në 4 punëtor të cilëve ju mungojnë çertifikatat për siguri dhe shëndet në punë sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Lidhur me këtë çështje është sqaruar mjaftueshëm më sipër. Sidoqoftë nga oferta me të cilën ka tenderuar parashtruesi është gjetur se për 11 punëtorë të parashtruesi mungojnë çertifikatat për siguri dhe shëndet në punë sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Por edhe sikur numri i këtyre punëtorëve pa çertifikatat në fjalë të ishte 4, sërish parashtruesi nuk do të kishte plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe do të duhej të ishte eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Ngjashëm edhe sa i përket pretendimit të tretë, nga oferta e parashtruesit është gjetur se plani dinamik nuk mund të hapet (as ky fakt nuk kontestohet nga parashtruesi). Prandaj në përputhje me konstatimet e komisionit vlerësues por edhe interpretimin e KRPP të cilit i referohet komisioni vlerësues, është gjetur se edhe ky pretendim është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara ndërsa parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht eliminimi i parashtruesit nga ky aktivitet i prokurimit sipas rekomandimeve të komisionit vlerësues është i saktë dhe i bazuar LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Vlen të shtohet se parashtruesi përveç që është tenderues i papërgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, ka ofertuar edhe me çmim i cili është në mënyrë të konsiderueshme më i lartë se çmimet më të lira se ato të parashtruesit.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.12.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shtetëror të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.